

KDU 323.1 (=18) "1960/1965"/091)

Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA**FORMIMI DHE VEPRIMTARIA E ORGANIZATËS PËR
BASHKIMIN E TROJEVE SHQIPTARE -1959 (OBTSH)**

Në vitet 1960-1965, në Kosovë zbulohen katër organizata ilegale. Në Anamoravë vepronte organizata e Metush Krasniqit me emrin "Partia Revolucionare për Bashkimin e Trojeve Etnike me Shqipërinë" (1958)¹; Në Pejë e rrethinë vepronte organizata ilegale e Remzi Balokut me emrin "Organizata për Bashkimin e Trojeve Shqiptare" (1959)²; Në Prishtinë, Mitrovicë e Gjiilan vepronte organizata e Kadri Halimit me emrin "Komiteti për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë" (1960)³ dhe organizata e Adem Demaçit me emrin "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve" (1963)⁴.

Formimi i Organizatës

Duhet cekur se shkak u kryesor i formimit të organizatës ilegale BTSH, pa dyshim se ishte robëria e tejskajshme dhe pakënaqësie e popullit shqiptar që kishte ngelur nën robërinë e shtetit të Jugosllavisë. Ndhimesën më të madhe në formimin e këtij organizimi ilegal, veç veprimtarëve të rinj në të kishin dhënë ndihmesën e vet edhe anëtarët më të vjetër që më herët kishin aderuar me një përkushtim të madh në ONDSH, por edhe shumë të tjerë që vite të shumta kishin kalua nëpër burgjet e ish-Jugosllavisë. Siç e cek edhe vet organizatori i organizatës, Remzi Baloku, në këtë, ndikim të dukshëm patën edhe veprimtarët : Sylë Shala, Sami Peja, Osman Baloku, Latif Nepola, Sylë Mehmeti, Nuradin Kastrati (Pejë), Fatmir Goranci nga Gjakova, Fejzë Runiku-Miftari nga Mitrovica, Zenel Kabashi nga Prizreni, Mustafë Nixha-Tafa me origjinë gjakovare por që jetonte në Prizren, po ashtu ndihmesë të madhe e të vazhdueshme kishin dhënë edhe Hafiz Jakupi nga Prizreni, Arif Hoxha nga Randobrava, Nezir Hoti nga Krusha e Madhe, Mulla Rama, nga ana e Podujevës si dhe Jusuf Dellova nga rrethina e Prizrenit.

1 Formimi dhe veprimtaria e organizatës ilegale "Organizata për Bashkimin e Trojeve Shqiptare" (OBTSH), 1959, fejton në 6 vazhdimë: *OBTSH-ja vazhdimësi e Lëvizjeve ilegale për çlirim dhe bashkim kombëtar; Epoka e Re, 19 maj 2011.*

2 Remzi Baloku, Ryzhdi Baloku. Kujtime si u themelua ilegalja "Organizata për Bashkimin e Trojeve Shqiptare". Pejë, 2004, 28.

3 Sabile Keçmezi-Basha. Të burgosurit politikë shqiptarë. Logos-A. Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2009, 204 pa aty, 27.

Dituria, mençuria dhe eksperiencia e veprimtarëve më të vjetër dhe rinia e guximi i veprimtarëve më të rinj bënë që organizata “BTSH” të formohej në vitin 1959 dhe të ketë një ndikim të madh dhe të sensibilizoi dukshëm veprimtarin ilegale atdhetare anë e këndë vendit të robëruar. Ndër anëtarët e rinj që u angazhuan qysh në fillim në organizatë ishin: Remzi Baloku (njëherë ky edhe ishte kryetar i organizatës), Zeçë Shala, Vesel Rexhepaj, Avdyl Shala, Dervish Shala dhe Mustafë Ademaj.

Dita e formimit të organizatës ishte caktua jo rastësisht 28 nëntori i vitit 1959 (Dita e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë), që në një mënyrë donte të thoshte se, shqiptarëve në tërësi iu ishte bërë një padrejtësi e madhe ngase jashtë shtetit shqiptar padrejtësisht ishin shkëputur gjysma e tokave shqiptare.

Qysh në ditën e themelimit të saj, pjesëmarrësit e mbledhjes kishin zgjedhur në mënyrë unanime kryetarin – Remzi Balokun, ndërsa për nënkryetar ishte propozuar e zgjedhur Sylë Shala, e për sekretar ishte propozuar që kryetari i organizatës të zgjidhte vet personin adekuat. Për sektorin financiar kishte dal propozimi që vet kryetari i organizatës të merrej me këtë çështje.

Po ashtu, në mbledhje si detyrë me rëndësi ishte marr përgatitja dhe hartimi i dokumenteve të organizatës siç ishin: Programi politik, Statuti dhe Plani operativ i aktiviteteve për veprimtari të organizatës. Pas një kohe dhe me një punë të madhe anëtarët kishin përgatitur të gjitha materialet për organizatën, kështu që në janar 1960 të gjitha dokumentet u miratuan nga anëtarësia e saj.

Në mbledhje ishin caktuar gjithashtu edhe udhëheqësit e resorëve të ndryshëm që vepronin në organizatë. Po përmendim vetëm rastin e atdhetarit të njohur-Sylë Shalën, i cili edhe më herët kishte qenë i dënuar politik si anëtarë i Organizatës Nacional Demokratike Shqiptare dhe kishte përvojë luftarake, ai njëzëri nga anëtarët e organizatës ishte caktua si udhëheqës i strategjisë luftarake që do të komandonte me rastin e formimit të grupeve të armatosura për çlirimin e Kosovës⁵.

Programi politik i organizatës

Pas disa mbledhjeve të mbajtura të organizatës, anëtarët e saj kishin hartuar gati të gjitha dokumentet për organizimin, mbarëvajtjen, qëllimet dhe vizionin e organizatës për vitet në vijim. Dokumenti kryesor, por që llogaritej edhe më përmbajtjesori për detyrat dhe qëllimet e organizatës

⁵ Remzi Baloku, Ryzhdi Baloku, Kujtime si u themelua ilegajla “Organizata për Bashkimin e Trojeve Shqiptare”, Pejë, 2004, 28.

pa dyshim se ishte Programi politik i saj, por që në thelb nuk ndryshonte shumë nga programet e mëhershme të lëvizjeve atdhetare kombëtare.

Programi i organizatës BTSH, sipas dokumentit të përkthyer nga hetuesit kishte vetëm nëntë pika që kërkohej nga anëtarët në mënyrë decisive edhe t'i përmbaheshin atij. Programi ishte i shkruar shkurt dhe shumë çart. Po i sjellim në tërësi pikat e programit:

1. Për zhvillimin dhe përtëritjen e organizatës duhet plotësuar me anëtarë të rinj të cilët kanë edhe qëllime patriotike.
2. Duhet zhvilluar dhe përhapur propagandën tek populli shqiptar.
3. Duhet krijuar një lidhje të plotë me organizatat shqiptare të cilat veprojnë në shtetet tjera të cilat kanë për qëllim çlirimin e tokave tona nën okupimin jugosllav.
4. Nëpër mes të këtyre organizatave e komiteteve duhet të përhapim propagandën në botën e jashtme, duke iu bërë të ditur qëllimet e revolucionit të popullit shqiptar.
5. Lufta për çlirim të plotë nga okupatori dhe klika titiste.
6. Likuidimin e të gjithë bashkëpunëtorëve të regjimit titist.
7. Duhet përzënë të gjithë ata të cilët kanë dominuar, kanë shfrytëzuar popullin shqiptar gjatë falsifikimit të revolucionit gjatë luftës dhe pas saj, duke e penguar popullin shqiptar për të ardhur deri te të drejtat e veta.
8. Pas çlirimit, organizata duhet të shpalli të gjitha tokat shqiptare me emrin Republika ILIRIA.
9. Duhet votuar rregullisht për përfaqësuesit e popullit.⁶

Programi përmbyllet me fjalët: Vdekje armikut tradhtar.

Liri tokave shqiptare.

Këto nëntë pika hetuesit e organeve të ndjekjes i kishin përkthyer në gjuhën serbe, por nuk do të thoshte se programi nuk kishte edhe pika tjera. Nga programi dhe deklaratimet e pjesëmarrësve del se programi kishte edhe këto pika që kishin karakter konkret të aktivitetit të organizatës si: Ditën e Pavarësisë së Shqipërisë (28 Nëntorin), propozonin që të festohej me shpërndarjen e pamfleteve e flamujve kombëtar nëpër vendet ma të rëndësishme dhe ku qarkullimi i njerëzve ishte shumë i madh. Veç këtyre kërkohej që anëtarët e organizatës të shpërndanin shumë parulla me karakter antijugosllav dhe kundër Serbisë, Titos e sistemit komunist.

Në mes tjerash sipas programit udhëheqësit e saj propozonin që të mblihdeshin ndihma (brenda mundësive) në të holla që të shfrytëzoheshin për nevoja të organizatës.

⁶ Arkivi i Kosovës, fondi :Gjykata e Qarkut, Pejë, dos. K. 74 64. 3, Prishtinë

Parashihej që aty ku ishte e mundur në organizata punuese, tek punëtorët të shkaktonin pakënaqësi dhe ata vet të bënin sabotime të organizuara në fabrikë e gjetiu dhe në shkolla të krijonin pakënaqësi dhe të vije deri tek bojkotimi i mësimi.

Për organizatën, primare ishte që nën 1: Ishte shumë më rëndësi që anëtarët e saj të hulumtonin, të evidentonin dhe të shënonin të gjithë bashkëpunëtorët e UDB-es, informatorët e tyre dhe bashkëpunëtorët e mundshëm të tyre, ngase kishin frikë nga mosnjohja, që dikush nga ata edhe mund të filtrohej në radhët e organizatës dhe zbuloheshin të gjitha grupimet që vepronin në terren; dhe nën 2. Duhej ditur se kush ishte tradhtari dhe herë- herë edhe mund të hakmerreshin ndaj tyre.

Detyrë me rëndësi ishte edhe sigurimi i armëve për nevoja të organizatës, por për t'i sigurua ishte shumë e vështir, andaj edhe ishte parapa që të siguroheshin mjetet enkas për blerjen e armatimit.

Duke hulumtuar në dokumentet e organizatës vijmë në të dhëna të bollshme se qysh në vitin 1960, anëtarët e saj kishin përgatitur shumë trakte e parulla të ndryshme për të shpërndarë nëpër qytet e fshatra të ndryshme të Pejës e më gjerë. Kishte raste kur flamujt kombëtar vizatoheshin me ngjyra, me dorë të lirë dhe këtë e bënin kryesisht nxënësit e shkollës Normale, që i angazhonin anëtarët e organizatës dhe po ashtu parullat e shumta u shkruan nga nxënësit me grafit ose ndodhte shpesh që ato të shkruheshin në rrugë, ku zakonisht përdorej gëlqerja.

Veprimtaria ilegale e organizatës

Anëtarët e organizatës, përveç punëve që i kryenin sipas programit, ata në rrethin ku jetonin e punonin kryenin edhe një mori aktiviteteve që lidheshin ngushtë me luftën e tyre të pa kompromis kundër okupatorit dhe sistemit komunist ku këtë sistem e shihnin si e keqja më e keqe që ka mundur t'i gjente shqiptarët.

Me kalimin e viteve numri i anëtarëve shtoj, duke formuar treshe të shumta në teren dhe në qytet. Duhet cekur se në mesin e anëtarëve të organizatës ishte edhe Ali Duriçi (Ali Baliu) që jetonte në Turqi. Ai për organizatën kishte sigurua flamujt kombëtar që i dërgonte nga Turqia dhe e kishte marrë për detyrë që ambasadat e huaj t'i njoftonte për gjendjen në Kosovë dhe të mbante kontakte të vazhdueshme me to.

Praktikë e rregullt e organizatës kishte qenë edhe kjo që pas çdo aktiviteti antishtetëror anëtarët e saj mblidheshin dhe diskutonin për mbarëvajtjen e punëve në terren. Anëtarët e OBTSH-së, rëndësi të veçantë i kushtonin ngritjes së vetëdijes së qytetarëve në përgjithësi dhe të anëtarëve të saj në veçanti. Si metodë për vetëdijesimin e masave, ata kishin caktuar

si detyrë shpërndarjen e literaturës patriotike. Në mesin e shumë librave që ishin shpërndarë duhet veçuar :“Lahuta e Malësisë ”, e Gjergj Fishtës; “Shqipëria çka qenë, ç’është dhe çdo të bëhet”, e Sami Frashrit e shumë libra të tjerë. Literatura kryesisht shpërndahej në shkolla filllore dhe tek te mesmet, ngase në të njëjtën mënyrë punonte edhe okupuesi që të bënte shpëlarjen e trurit në mënyrë sistematike.

Sipas të dhënave, në organizatë mbledhjet mbaheshin rregullisht. Ato kryesisht mbaheshin në dyqanin e Remzi Balokut (rrobaqepësi), në qytet, zakonisht pas përfundimit të orarit të punës, atëherë kur shkonin punëtorët nëpër shtëpitë e tyre. Shpesh u mbanin edhe në shtëpinë e kryetarit, por jo rrallëherë edhe në shtëpinë e Osman Balokut. Ndërsa, mbledhjet ku diskutohej për aktivitete të ndryshme të anëtarëve të organizatës mbaheshin tek anëtarët e komitetit të fshatit në fshatin Loxhë si në shtëpinë e Zeçë Shalës, Ukshin Shalës, si dhe në Pejë tek Shabush Luci e Kamber Ukajt. Por, shpesh ndodhte që gjatë stinës së verës, për të mos rrezikua anëtarësinë e familjarët e tyre, mbledhjet organizoheshin në fusha, natën nën dritën e hënës por vazhdimisht të mbrojtur nga rojet e armatosura nga anëtarët.

Mbajtja e mbledhjeve

Vetë anëtarët e organizatës flasin se si ishin mbajtur mbledhjet dhe ecurinë e tyre. Çdo mbledhje fillonte me ngritjen e anëtarëve të organizatës në këmbë, në këtë mënyrë ata në një mënyrë bënin nderimin e të gjithë të rënëve që kishin luftua dhe kishin rënë në mbrojtje të atdheut dhe përfundonin me moton: Vdekje tradhtarëve, Kosova shqiptarëve”.

Për vendin dhe pjesëmarrjen në mbledhje kryesisht caktoheshin dhe merrnin pjesë njerëzit më të besueshëm të saj, ato ishin shumë konspirative dhe pas përfundonte minuta e heshtjes, anëtarët miratonin rendin e ditës, dhe zakonisht si pikë e parë ishte fjala hyrëse me qëllim të motivimit për aktivitet.

Për fjalë hyrëse zakonisht zgjidhej ndonjë citat i marr nga programi i organizatës si p.sh. “Tokat shqiptare janë okupuar me forcë, janë copëtuar dhe në kundërshtim me vullnetin e shqiptarëve, Serbia e Mali i Zi dhe fqinjëve të tjerë që i kemi për rreth i kanë aneksuar”. Më pastaj vazhdonin duke shpjeguar pse organizata është pagëzuar mu me këtë emër “Bashkimi i Tokave Shqiptare”, çka do të thotë se, bashkim i trojeve etnike shqiptare, e që nënkupton edhe bashkimin kombëtar, pra në këtë mënyrë shqiptarët do të bëhen fuqi e respektuar si nga miqtë ashtu edhe nga armiqtë, prandaj duhet të angazhohemi në realizimin e synimeve të natyrshme për bashkim, sikurse kanë arritur edhe popujt e tjerë të Ballkanit dhe të Evropës. Duhemi të angazhohemi që synimi i të gjithë shqiptarëve të jetë rikthimi i

të gjitha trojeve shqiptare të okupuara, duke e sakrifikuar edhe jetën e që me bashkimin e tyre, shtetin tonë do ta emërtojmë me emrin ILIRIA, ku pasardhësit tanë nuk do të brengosen për ardhmërinë e vetë,⁷ thuhej në programin e organizatës së BTSH-së.

Statuti i OBTSH-së

Organizata e BTSH-së, veç Programit kishte hartuar edhe Statutin e vet. Qysh në mbledhjen e parë ishte marr vendim që organizata të mos ketë ndonjë parashtesë apo prapashtesë ideologjike nga se në të mund të aderojnë të gjithë personat të cilët reflektojnë dhe angazhohen për bashkimin kombëtar dhe zgjidhjen e çështjes shqiptare. Në të ardhmen, parashihej që rregullimi shtetëror të jetë në bazë të vullnetit të popullit edhe pse të gjithë anëtarët ishin të orientuar dhe mbështetnin rregullimin demokratik të perëndimit.

Po ashtu, parashihej me Statut që organizata të veproi në bazë të komiteteve vendore, gjegjësisht të grupeve operative në krye të së cilës do të veprojë Komiteti i Përgjithshëm Nacional (Kryesia Qendrore).

Sipas këtij dokumenti pune, ishte paraparë që funksionimi i organizatës të zhvillohej përmes rrjetit të grupeve të vogla, në mënyrë që operativa të zhvillohej më lehtë, duke marrë parasysh rrethanat në të cilat e zhvillonte veprimtarinë organizimi ilegal.

Veprimtarët e rinj sipas statutit mund t'i bashkëngjiteshin organizatës së BTSH, pasi të verifikoheshin për gatishmërinë sakrifikuese për çështjen kombëtare, e pastaj iu shpjegohej programi i organizatës.

Sipas statutit, organizata mëntonte të jetë politike dhe militante, statuti parashihte veprimtari ilegale sipas sistemit nga lart-poshtë, ku kryetari, nënkryetari, kryesia kishin kompetenca sipas hierarkisë që mund të veprohet për arsye të ilegalitetit edhe përmes: udhëzimeve, emërtimeve, urdhëresave, dekreteve etj., deri te kryetarët e grupeve operative.

Strategjia për veprim

Veç dokumenteve kryesore që kishin përpiluar anëtarët e OBTSH-së, ata kishin hartuar edhe Planin strategjik për veprim. Për strategjinë e veprimit për bashkimin e trojeve shqiptare dhe çlirimin kombëtar parashihnin mobilizimin e forcave e që i kishin përfshi në tri pika kryesore:

⁷ Remzi Baloku, Ryzhdi Baloku, Kujtime si u themelua ilegalja..., Pejë, 2004, 36

1. Nga poshtë dhe nga brenda, duke mos e lënë anash as konceptin strategjik.
2. Nga lart dhe nga brenda, që do të vepronte në harmoni me të parën.
3. Nga lart dhe nga jashtë që do të shërbej si ndihmesë e dy të parave.⁸

Në bazë të pikave që i prezantojnë anëtarët e OBTSH-së, me rëndësi të veçantë ishte mbështetja e popullit e cila nga gjiri i vet do të nxjerr udhëheqës për t'i drejtuar, pa u largua nga brendia e popullit, e ndërsa ai nga lart dhe nga brenda duhet të vepronte në një harmoni me të parën, duke mos e lënë anash as faktorin e jashtëm në bazë të veprimit nga lart që do të shërbente si faktor ndihmës.

Bashkëpunimi ndër organizativë i ilegales

Organizatave e ilegales që vepronin në Kosovë, lirisht mund të thuhej se gati të gjitha kishin njohuri për aktivitetin e njëra tjetrës. Andaj edhe ishte krejt e natyrshme që shumë herë edhe ishte tentuar që të lidheshin në mes veti.

Por, duhet përmendur edhe këtë se shumë shpesh në formimin e organizatave e grupeve ilegale në Kosovë, në të shumtën e rasteve, atdhetarët nga rajone të ndryshme, janë angazhuar dhe kanë zhvilluar aktivitet të dendur në organizata ilegale atdhetare, që qendrat e tyre i kishin jashtë qytetit të Pejës.

Duhet përmendur rastin e organizatës të Kadri Halimit që vepronte në atë kohë "Komiteti Revolucionar për Bashkimin e Kosovës me Shqipërinë"(1960), në të cilën para gjyqit dolën dhe u dënuan shumë atdhetar që vinin nga rajone tjera të Kosovës. Po ashtu edhe në organizatën e Remzi Balokut "Organizata për Bashkimin e Trojeve Shqiptare" (1959) që vepronte në territorin e Pejës, por në të vepronin edhe shumë atdhetar nga ana e Mitrovicës.

Në bazë të të dhënave që kam, në rajonin e Pejës ka vepruar edhe organizata e LRBSH-së në krye me Adem Demaçin. Pas organizimeve të shumta që kishte bërë kjo organizatë në shumë qytete të Kosovës, për koordinatör për formimin e komitetit të LRBSH-së për Pejë kishte caktuar Ramadan Shalen.

Ndërsa, kryetari i organizatës BTSH, në kujtimet e veta thotë edhe këtë se në vitin 1963, nga burimet që posedoja, dëgjova se veprimtari i dalluar i çështjes kombëtare Adem Demaçi, ishte i njoftuar për ekzistimin e organizatës ilegale me seli në Pejë, qëllimi i së cilës ishte bashkimi i trojeve shqiptare, prandaj kishte shprehur dëshirë të kontaktojë me

⁸ R. Baloku, vepër e cituar... 32.

mua. Me të dëgjuar për këtë unë e shpreha gatishmëri për ta vizituar. E konsultova bacën Sylë dhe vendosa që me veti ta marrë Ali Sylqën (në atë kohë student), i cili shpesh më shoqëronte në takime të ndryshme.⁹

Në bazë të të dhënave që kemi edhe pse Remzi Baloku kishte udhëtuar për Prishtinë, edhe pse e kishte kërkuar gjatë Adem Demaçin, më kot ngase ata në rrugëtimin e tyre përcilleshin hap pas hapi, andaj edhe qenë të detyruar që të ktheheshin në Pejë pa kontaktuar me të.

Pas një kohe, sipas të dhënave të Remzi Balokut, Adem Demaçi kishte shkuar në Pejë, por edhe kësaj radhe nuk kishin pasur fatin që të takohen. Aty, ai takohet me Ramadan Shalen, i cili për veprimtarin e organizatës BTSH ishte në ngjarje përmes Esat Miftarit, i cili në atë kohë kishte ikur për Shqipëri. Por, thekson Remzi Baloku se Ramadani nga ai personalisht e kishte kërkuar Programin e organizatës, rregull e pashkruar ishte që edhe kryetari të konsultohet me anëtarët, andaj edhe ishte konsultuar me Sylë Shalën dhe vendosin që vetëm disa pika të programit të përshkruara t’ia japin.

Gjatë ishte punuar për bashkimin e këtyre dy organizatave, por anëtarët e OBSHT, si kusht për bashkim të tyre kishin vu: “Po, pasi që jemi organizatë më e vjetër me veprimtari, kështu është që programi i organizatës BTSH të jetë bazë për veprimtarinë e organizatës”¹⁰ dhe me kaq kishte përfunduar, se më askush nuk ishte lajmëruar nga organizata e LRBSH-së.

Ndërsa sipas një shkrimi që e jep Selatin Novosella në librin “Kosova ‘64” Prishtinë 1994, f.105, thuhej se: “Pasi që vërtetohet se në Pejë vepronte organizata e Remzi Balokut, bijën në kontakt dhe në nëntor të vitit 1963 në Mitrovicë mbahej takimi në mes të dy organizatave. Nga ana e Komitetit Revolucionar merr pjesë Adem Demaçi dhe përfaqësuesit e Mitrovicës, Zeqir Gërvalla, Hysen Daci dhe Mustafa Venhari si dhe përfaqësuesit e organizatës ilegale nga Peja, Ramadan Shala. Pas shumë bisedave lidhur me bashkimin e të gjitha grupeve e organizatave ilegale që vepronin në Kosovë, propozohet që Selahudin Daci nga Peja të jetë koordinator në mes Prishtinës e Pejës”¹¹.

9 R. Baloku, R. Baloku, Kujtime.....f.38.

10 R. Baloku e R. Baloku, vepër e cituar... f. 39.

11 Selatin Novosella, Demonstratat e gjashtëdhjetetës, Prishtinë, 2008, 77-78.

Ngritja e Flamujve

Edhe pse nuk kishte ardhur deri te bashkimi i dy organizatave, megjithatë bashkëpunimi ishte i ndërsjellë. Të gjitha organizatat që vepronin deri në vitin 1968, duhet përmendur se kishin një qëllim dhe një ideal. haptas kërkonin bashkimin e Kosovës e të trojeve tjera shqiptare nën Jugosllavi që të bashkoheshin me Shqipërinë. Dallimi i tyre ishte vetëm në atë pikë se si duhet t'i qaseshin zgjidhjes së saj.

Sipas kujtimeve të Remzi Balokut, për Ramadan Shalën thotë se ai kishte formuar grupin e vet në kuadër të LRBSH-së. por kontaktet me të dhe anëtarët e BTSH-së ishin të rregullta. Në mes të shumë takimeve, Ramadani një ditë i kishte njoftuar se në Pejë do të ngritën në disa vende të caktuara flamujt kombëtar. Kishte kërkuar nga ata që të marrin pjesë dhe bashkërisht të vepronin. Anëtarët e BTSH nuk marrin pjesë në ngritjen e flamujve por iu kishin huazua para¹² për blerjen e tyre.

Flamujt u ngritën më 12-13 prill të vitit 1964, në disa qytete të Kosovës, por edhe në Pejë. Një aksion i tillë u vlerësua lart nga anëtarët e organizatës të BTSH-së dhe u cilësua si ngjarje me një rëndësi të madhe historike e kombëtare.

Torturat gjatë hetuesisë

Pasi se organet e ndjekjes e kishin zbuluar veprimtarinë e anëtarëve të organizatës ilegale që vepronte në Pejë dhe rrethin, ata (udbashët) menjëherë kishin marr aksione për arrestimin e tyre. Maltretimet dhe torturat kishin filluar menjëherë posa kishin bërë takimin e parë me familjaret dhe me vet personat që kishin zhvilluar aktivitet antishtetërore dhe antijugosllav.

Në momentin e procesit të arrestimit, udbashët në njëfarë mënyre bënin edhe një lloj spektakli, ngase fillimisht me vete merrnin një numër të madh të policëve të veshur e të armatosur gjerë në dhëmb. Ata në vendin e caktuar angazhonin shumë vetura që i quanin "marica" që i përdornin për t'i futur në to të arrestuarit. Ata në qetësin më të thellë rrethonin fshatin (ky ishte rrethi i parë), pastaj rrethonin lagjen (rrethi i dytë) dhe rrethi i tretë ishte vet hyrja e tyre në shtëpi. Spektakli fillonte me hapjen e derës së shtëpisë dhe kushdo që qëllonte i pari, policët i drejtonin tytën e pushkës dhe me fjalët më banale e fyenin duke i thënë "dorëzohu". Dyert e shtëpisë i thyenin me shqelma, duke krijuar shamatë të madhe dhe duke u futur në dhoma gjumi pa paralajmërim, ndërsa ato të hyrjes nuk i thyenin por futeshin duke kërcyer mbi mure brenda oborrit si hajdut pa zhurmë.

¹² R. Baloku, vepër e cituar... 40.

Në kujtimet e veta, tregon zotëri Remzi Baloku se kur kanë hyrë brenda, rastësisht i pari kishte dëgjuar rrapëllimën babai i Remzi Balokut dhe pa ditur se çfarë po ndodhte ai ishte zgjuar dhe kishte dalë për të parë se çfarë kishte. Kur në derë kishte parë policin dhe në pyetjen e tyre se ku po shkonte, ai iu kishte thënë se po shkonte në tualet që ishte në oborr. Por, kur ai iu kishte drejtuar atyre se “ata çfarë po kërkoni këtu”, ata iu ishin përgjigjur se po kërkoni Remzi Balokun. Në thirrjen e babait se “Remzi, jemi rrethuar”, ai kishte brofur në këmbë dhe kishte fillua të vishet. Të gjitha dyert e dhomave në shtëpi i kishte thyer policia. Para fëmijës e familjarëve i kishin vu prangat.

Mund të merret me mend një vrazhdësi, vandalizëm e dhunë e tillë në një rreth familjar. Çfarë mbresash do të kenë në të ardhmen motrat e vëllezërit e tij që ishin më të ri se ai. Por, këtë udbashët e bënë me qëllim. Me qëllim që tek familjaret të fuste frikën dhe mos të tentohej për ndonjë veprimtari antishtetërore në vijim. Por, tek familja Baloku dhe te të gjitha familjet shqiptare gjatë tërë historisë kjo pati efekt negativ. Sa më shtohet dhuna edhe aq më tepër shtohet urrejtja për okupuesin dhe rezistenca ndaj saj.

Torturat ndaj të arrestuarve sipas të dhënave, fillonin menjëherë posa i arrestuari shkelte në zyrat e hetuesve. Fillimisht iu bënte një “pritje” nga dhjetë e më tepër hetues. Pastaj pasi i ofronin karrigen pa mbështetëse, fillonin grushtimet në trup e në kokë, e vazhdonin derisa i burgosuri allivanosej.

Ndaj të burgosurve përdroreshin metoda të ndryshme dhune, vetëm e vetëm për të treguar shokët me të cilët kishin bashkëpunuar. Njëra ndër metodat më të shpeshta që është përdorur ndaj tyre, ka qenë metoda e presionit psikologjik duke e bindur se “shokët e tu të gjithë kanë pranua se kanë bashkëpunua me ty”.

Metodë tjetër e dhunës ishte edhe kjo se i burgosuri merrej në pyetje nga dy ditë pa ndërprerë. Ndërroheshin hetuesit por jo edhe i burgosuri. Ai nuk guxonte as të dremiste e mos të flasim për të fjetur. Pas lodhjeve e mundimeve të një pas njëshme, të burgosurve iu ofronin deklaratat e shkruara nga vet udbashët, duke i detyruar që të nënshkruanin për të veten. Dhe duhet besuar se i burgosuri as nuk ishte i vetëdijshëm se çfarë nënshkruante dhe kënd e akuzonte.

Ka pasur raste kur të burgosurit i ofronin ushqim tejet të kripur, por pas një kohe të gjatë që nuk kishte ngrënë, por kur fillonte etje për ujë, assesi ujë nuk i jepnin, ndërsa aty pran e lëshonin kroin që të rridhte uji.

Veç këtyre metodave që i përmenda, duhet cekur se ndaj të burgosurve politik janë përdorur edhe ndrydhja në vendet më të ndjeshme të trupit, zhytja në ujë të ftohët gjatë stinës së dimrit, shpërthimi i gishtërinjve ndër

thonj me gjilpëra, djegia e lëkurës së trupit me cigare, e udhëbështë dinin të shkonin edhe më larg kur edhe i likuidonin fizikisht të burgosurin politik.

Zbulimi i anëtarëve të OBTSH-së

Sipas të dhënave që i japin themeluesit e organizatës, del se OBTSH-ja ka zhvilluar një aktivitet të dendur në Pejë e rrethin mbi pesë vite. Por e kemi cekur edhe më lartë se në këto vite vepronin edhe dy e më shumë organizata ilegale të cilat zhvillonin një aktivitet të dukshëm në teren. Po në këtë kohë, organet e ndjekjes po ashtu hetonin me mjeshtri duke përfutur e bindur që të bashkëpunonin me shtetit.

Me aktakuzën e Prokurorisë Publike të Qarkut në Pejë me nr. 57/64, më 6 gusht e ka ngritur dhe e ka përfaqësuar Bozhidar Babiqi, prokuror publik i Qarkut të Pejës.

Procesi gjyqësor ndaj anëtarëve të LRBSH-së dhe OBTSH-së

Procesi gjyqësor ndaj të akuzuarve politik u organizua në muajin gusht në gjykatën e Qarkut të Pejës. Këshillin gjyqësor e përbënin: Zhivoin Cvejiq (kryetar i gjykatës), kryetari të Gjyqit Komunal të Pejës Sahit Meraku dhe gjyqtarëve porotë: Sherif Boshnjakut, Trajko Angjellkoviqit e Osman Bytyqit dhe procesmbajtëse ishte Zorica Malikoviq.

Të pandehurit ishin: Ramadan Shala, Shefqet Deçani, Remzi Baloku, Ahmet Zeka, Niman Podrimja, Nezir Gashi, Sylë Shala, Ejup Kastrati, Mehmet Krasniqi, Vesel Rexhepaj, Avdyl Shala dhe duhet përmendur se situata politike, ekonomike e arsimore në Kosovë ishte nën çdo nivel. Andaj të akuzuarit shqiptarë për tu mbrojtur para trupës gjyqëse, në mungesë të avokatëve shqiptarë ishin të detyruar që të angazhonin si mbrojtës të tyre, avokatët nga komuniteti serb dhe mund të merret me mend se çfarë mbrojtje është përgatitur për atdhetaret tanë. Për këtë proces i kishin angazhuar :Bozhidar Babiqin, Boshko Boshkoviqin, Petar Kazhiqin, Milutin Gjuriqin, Dragan Zonjiqin, Vllado Vllahoviqin dhe Millutin Gjuriqin¹³. Andaj edhe një proces i tillë gjyqësor ishte krejt i pritur. Kush do t'i mbronte shqiptarët e akuzuar? Shtrohet pyetja. Një mbrojtje e këtillë dhe me këtë përmbajtje vështir se do të sjell diçka të mirë të shqiptarëve të akuzuar.

¹³ Aktgjykimi i grupit të Pejës, Gjykata e Qarkut, Pejë 1964.

Kush ishin shqiptarët që akuzoheshin

Para trupit gjykues në gjykatën e Qarkut të Pejës dolën njëmbëdhjetë persona:

1. Ramadan Shala, student nga Peja, i lindur më 1935 në Pejë, kishte të mbaruar Shkollën e Mesme Financiare. Që nga data 8 qershor 1964 ndodhej në burgun hetues.

Në aktgjykimin e datës të 21 gushtit 1964, Ramadan Shala akuzohej se në kohën prej muajit nëntor 1963 e deri në maj 1964, pas konsultave që kishte pasur me Shefqet Deçanin, ai kishte bisedua edhe me Ahmet Zekën, Niman Podrimajn, Mehmet Krasniqin Ejup Kastrati, Nezir Gashin dhe me disa persona të tjerë nga Peja e rrethina me ç'rast i kishte njoftuar për nevojën e krijimit ose me ekzistimin e grupit ilegal, me detyrat dhe qëllimet e grupit dhe ata të cilët kanë shprehë dëshirën për t'u angazhuar në këtë veprimtari i ka pranuar dhe i ka këshilluar në zgjerimin e grupit me anëtarë të rinj, iu ka dhënë si detyrë që sa më shumë të mbledhin dhe të grumbullojnë ndihma vullnetare, në sigurimin e materialeve teknike, në angazhimin e punëve diverzive, në mbledhjen dhe sigurimin e armëve, në përgatitjen e aksioneve të armatosura, për shpërndarjen e trakteve e materialeve tjera antishtetërore dhe antijugosllave.

Po nga këta muaj (nëntor 1963- qershor 1964), po ashtu është takuar me Remzi Balokun e Sylë Shalën, duke mbajtur shumë mbledhje të përbashkëta dhe duke u munduar që t'i bind që grupi ilegal i tyre (OBTSH), të bashkohej me grupin e tyre dhe në të ardhmen aksionet dhe të gjitha veprimtarit në Pejë e rrethin të kryejnë bashkërisht.

Po ashtu, gjatë muajit nëntor 1963 në qytetin e Pejës është takua me Hysen Dacin, nga një grup ilegal që kishte veprua në Mitrovicë dhe ky e kishte njoftua se në Mitrovicë e Prishtinë ekziston e njëjta organizatë dhe nëpërmes të tij kishte caktua takim me atdhetarin e madh Adem Demaçin.

Në kohën prej nëntorit të vitit 1963 e deri në qershor 1964, kishte mbajtur shumë takime me Adem Demaçin në Mitrovicë, Prishtinë dhe Pejë. Gjatë kësaj periudhe është bërë marrëveshja për unisimin e punëve të grupeve, ndërmarrjen e aksioneve, për mundësin e kryerjes së tyre dhe për kohën e kryerjes për nevojën e zgjerimit të mëtejshëm të grupeve, për formimin e udhëheqjes qendrore dhe për formimin e udhëheqësve lokal në disa vende, për nevojën e mbledhjes së armëve dhe përgatitjen për sulme të armatosura dhe për diversione në kabinetet e paraushtarakve në Postat e Milicisë popullore, për nevojën e lidhjes me Shqipërinë ose me cilindo qoftë shtet të huaj i cili kishte me iu dhënë ndihmë. Pastaj anëtarëve të

grupit iu kishte lexua programin e Statutit e organizatës, po ashtu edhe iu ka shpërndarë anëtarëve.

Po ashtu, gjatë muajit shkurt 1964 i kishte mbledhur 56.200 din. Të gjitha këto para ishin ndihmë vullnetare prej anëtarëve të grupit të tij, të grupit të Ramiz Balokut dhe prej grupit të Gjakovës dhe këto të holla i kishin përdorur për sigurimin e materialit teknik, siç ishte blerja e makinës së shkrimit, gështëtneri, flamujt kombëtar etj.

Më 4 prill në Prishtinë i kishte marrë 25 flamuj kombëtar, nëpërmes të Adem Demaçit, i kishte sjell në Pejë të cilët më 12 e 13 prill i kishin ngritur në vende të përshtatshme në Pejë, Gjakovë Novosellë e Carabreg.

Më 11 prill 1964. Teki Dervishit nga Gjakova ia ka dhënë 16.200 din, për të blerë një gështëtner për nevoja të grupit ilegal.

Kah fundi i prillit 1964, po ashtu në Gjakovë ka organizua një takim me Murteza Nurën dhe me grupin e Gjakovës në të cilën ka kërkua që sa më shumë me grumbullua mjete për blerjen e armëve për nevoja të organizatës dhe me i zgjeruar radhët me anëtarë të rinj dhe me punua sa më shumë për me ra në lidhje me persona nga Shqipëria. Edhe më 10 maj 1964 përsëri në Gjakovë ka mbajt mbledhje me Murteza Nuren dhe anëtarët e tjerë ku është diskutuar që një person duhet dërguar në Shqipëri për të vu kontakt me pushtetin e atjeshëm. Po ashtu, më 24 maj 1964, në Pejë i ka ftua në takim Murteza Nurën e Asim Vulën dhe me anëtarë të tjerë të grupit të Gjakovës, ku për detyrë iu ka dhënë që menjëherë të formojnë udhëheqësin lokale dhe anëtarëve t'iu caktojnë detyra konkrete.

Po ashtu, prej tetorit 1963 e deri më 7 qershor 1964 Shefqet Deçani e ka njoftua për zgjerimin dhe angazhimin e personave të rinj në grupet ilegale si dhe e ka njoftua se grupi ilegal i Mitrovicës, i Gjakovës, i Prishtinës kanë bërë unisimin e tyre si në program, Statut dhe kishin vendosur që të kryenin aksione të përbashkëta.

2. Shefqet Deçani ishte i lindur në Pejë më 1935. Jetonte dhe punonte në Prishtinë. Kishte të mbaruar Fakultetin Juridik. Ishte arrestua në të njëjtën dite sikurse edhe Ramadan Shala, më 8 qershor 1964.

Shefqet Deçani në bashkëpunim me Ramadan Shalën, kishte marr pjesë në krijimin e grupit ilegal të Pejës. Ai tërë veprimtarin e vet atdhetare e kishte zhvillua në mes të muajit nëntor 1963 dhe muajit maj 1964, duke e këshilluar vazhdimisht Ramadanin që të ketë kujdes se kujt po i ofrohet dhe me kënd po zhvillonte e po angazhonte në veprimtarin ilegale. Shefqet Deçani me këmbëngulje kishte kërkua nga Ramadani që rregullisht ta njoftonte për përfshirjen e anëtarëve të rinj dhe për aksionet që do i ndërmerre.

3. Remzi Baloku, me profesion ishte rrobaqepës. Kishte lindur më 1935 në qytetin e Pejës. Ndërsa, po ashtu në Pejë kishte mbaruar dy klasë të Shkollës së nxënësve në Ekonomi. Edhe ky ishte arrestua më 8 qershor 1964.

Remzi Baloku si aktivist i dalluar i organizatës OBTSH-së në Pejë. Gjikata e akuzonte se ai gjatë viteve mars 1963 dhe qershor 1964, në Pejë e në Loxhë ishte takua dhe kishin mbajtur mbledhje të shumta me Sylë Shalën, Vesel Rexhepajn si dhe me Zeqë Shalën, Kamer Ukajn, Sefer Muratajn dhe me disa persona të tjerë duke i bindur se kishte ardhur koha se edhe në këtë pjesë të Dukagjinit duhet të formohet një grup (organizatë) ilegale dhe i kishte njoftua se çfarë qëllimi do të ketë. Personat të cilët kishin pranua që të hynë në grup. Iu kishte obligua që të formonin grupet e veta dhe të angazhoheshin në zgjerimin e radhëve dhe në grumbullimin e të mirave materiale. Të hetojnë me kujdesin më të madh të gjithë personat që bashkëpunojnë dhe punojnë në organet e UDB-es dhe i njoftojnë ata për veprimtari ilegale të shqiptarëve.

Një ditë të pa caktuar (e kjo shprehje e pa caktuar, gjatë tërë shkrimit të aktgjykimit përdorej shumë, ngase organet e hetuesisë nuk kishin mundur të zbulonin në tërësi veprimtarin e organizatës). Andaj edhe shprehja “një ditë të pacaktuar”, përdoret edhe në këtë rast, për afërsisht ceket vetëm muaji nëntor 1963, në fshatin Loxhë formohet grupi ilegal i organizatës OBTSH-së dhe me këtë rast Remzi Baloku iu ndan detyrat, duke e caktuar kryetarin, sekretarin dhe personat përgjegjës për mbrojtje, milici dhe çështje ushtarake, po ashtu u paraqit edhe nevoja që sa më shumë të bëhet angazhimi i të rinjve, mbledhjen e armëve dhe të bëhen përgatitje sa më të mira për aksione diversantë dhe zbulimin e personave për të cilët supozohej se bashkëpunonin me organet e sigurimit.

Po ashtu, pas takimit dhe formimit të grupit Remziu ka mbajtur edhe një takim tjetër në të cilin anëtarët e grupit iu ka lexua programin dhe statutin e organizatës dhe iu ka lexuar pjesë nga gazeta “Shqipnija e Lirë” (këtu është një gabim ngase gazeta e Komitetit Kombëtar Demokrat “Shqipnija e Lirë” si organ të vetin ka pasur gazetën “Qindresa Shqiptare”, ku edhe kuptohet se iu ka lexuar pjesë nga kjo gazetë e cila në Kosovë ishte futur ilegalisht dhe botohej në Paris të Francës).

Gjatë veprimtarisë së tij ilegale, Remzi Baloku ka mbajtur shumë mbledhje me grupet ilegale, po ashtu ka mbajtur lidhje të vazhdueshme edhe me emigracionin shqiptar që ka qenë i shpërndarë nëpër botë. Dihej për takimin e tij me Bali Aliun nga Turqia nga i cili ka kërkuar që pas kthimit në Turqi të takohej me Zenel Bobin që ta njoftoj atë me ekzistimin e grupit ilegal dhe në një mënyrë ta ndihmoj këtë grup.

Po ashtu, prej nëntorit 1963 e deri në qershor 1964 ka mbajtur shumë takime me Ramadan Shalën dhe në ato takime vazhdimisht është bisedua që të bëhet bashkimi i dy grupeve ilegale, për nevojën e aktivitetit të tyre të përbashkët dhe të ekzistimit të programit politik të tyre të përbashkët. Edhe pse në librin e Remzi Balokut thuhej se OBTSH-ja qysh herët kishte hartua programin e tyre politike, megjithatë kur Ramadan Shala i ofron programin e organizatës së vet, ai e merr për ta lexua dhe disa pika të tij i përshkruan dhe iu lexon anëtarëve të organizatës si në Pejë po ashtu edhe anëtarëve në Loxhë.

Sipas aktgjykimit thuhej se Remzi Baloku, me anëtarët e vet kishte grumbullua 10.500 din, ndërsa ai vet i kishte dhënë 4.500 din, e të gjitha këto të holla ia kishte dorëzua Ramadan Shalës, për të blerë gësitëtrnerin që do e përdorin për shumëzimin e materialit propagandues të organizatave.

Në bazë të të dhënave që i ofrojnë organet e ndjekjes si dhe vet pjesëmarrësit e organizatave thuhej se në mes të organizatës BTSH-së dhe LRBSH-së, nuk kishte ardhur deri te bashkimi i tyre për hir disa ndryshimeve të vockla programore. ata kishin marr qëndrim që të bashkëpunojnë dhe të ndihmohen në aksione dhe veprimtari të ndryshme ilegale.

Gjithashtu, Remzi Baloku ka qenë i njoftuar se në Kosovë kishte hyrë një grup diversantësh nga Shqipëria dhe në mesin e tyre ndodhej edhe vëllai i Avdl Shalës- Ramadan Shala dhe bashkë me të kishin ardhur edhe këngëtari i njohur që kishte ikur për Shqipëri Dervish Shaqa e Adem Dushku të cilët i kishte shoqëruar edhe një person tjetër i panjohur për ta. Me këtë rast Remzi Baloku kishte kërkuar nga Avdyl Shala që ta lidhte me grupin e për nevoja të grupit kishte kërkuar që t'iu falshin revolen e markës "Parabellum", me ç'rast Ramadan Shala ia kishte fal vëllait të vet.

Veç kësaj revoleje, për nevojat e grupit Remzi Baloku kishte sigurua nga një person i panjohur edhe një revole të markës "Valter" dhe një pushkë me prejardhje italiane prej një personi nga Isniqi, të cilën më vonë ia kishte dorëzua për me e fsheh Kamber Ukajt.

Gjatë vitit 1963 e deri në muajin qershor 1964 në Pejë e në Loxhë në grupin e organizatës ilegale OBTSH, e cila kishte për qëllim sulmin ndaj rregullimit shtetëror e shoqëror të RSFJ-së dhe në tërësinë e saj tokësore si dhe në shkatërrimin e bashkimit të popujve të Jugosllavisë mermin pjesë edhe Ahmet Zeka, Niman Podrimaj, Nezir Gashi, Sylë Shala, Ejup Kastrati, Mehmet Krasniqi, Vesel Rexhapaj e Avdyl Shala.

4. Ahmet Zeka kishte lindur më 1939 në Pejë. Ishte student në Fakultetin e Ekonomisë. U arrestua me 9 qershor 1964. Ahmet Zekaj akuzohej se në vitin 1963, ishte takuar me Ramadan Shalën dhe me këtë rast ishte njoftuar për organizimin e grupit ilegal dhe me këtë rast

bëhet anëtarë i saj. Më 10 prill 1964 i kishte kontrollua rrugët e Pejës dhe kishte marrë pjesë në caktimin e vendeve për vemjen e flamujve kombëtar në qytet.

5. Niman Podrimaj ishte i lindur në fshatin Corollukë më 10 tetor 1938. Kishte të mbaruar shkollën fillore dhe kursin e daktilografisë, punonte si nëpunës. Në burgun hetues ndodhej që nga 25 qershori 1964. Edhe Niman Podrimaj ishte anëtar i organizatës së LRBSH-së qysh nga nëntori i vitit 1963. Ai pas një bisede që kishte pasur me Ramadan Shalën, pranon që të angazhohet dhe kishte pranua të gjitha detyrat që i caktonte grupi. Ishte angazhuar që në komunën e Istogut të anëtarësonte anëtarë të rinj, ishte kyçur në aksione dhe grumbullimin e armëve për nevoja të organizatës. Më 11 prill 1964 i kishte marrë 5 copë flamuj kombëtar nga Ramadan Shala dhe nëpërmes të Tahir Elezit, natën në mes të 12 e 13 prillit, dy prej tyre e kishte ngrit në Novosellë.

6. Nezir Gashi me profesion ishte mësues nga Grabovci (komuna e Pejës), ndërsa ishte i lindur në Mamuras- Shqipëri. Kishte të mbaruar Shkollën Normale, në burgun hetues ndodhej që nga 31 korriku të vitit 1964. Nazir Gashi pasi se kishte pranua të ishte anëtar i organizatës, ai ishte angazhua në shumë veprimtari të grupit ilegal, po ashtu kishte qenë i rregullt në mbledhjet e saja (24 maj 1964). Me propozimin e Ramadan Shalës ishte caktua që të kryente detyrën e sekretarit të grupit që vepronte në Pejë.

7. Sylë Shala ishte i lindur në fshatin Lybeniq më 1911. Kishte të mbaruar tri klasë të shkollës fillore. Ishte punëtor. Në burgun hetues ndodhej që nga 8 qershori 1964. Qysh nga viti 1963 ishte bërë anëtar i grupit të Remzi Balokut. Po ashtu, kishte pranua që të angazhohej në zgjerimin e organizatës me anëtarë të rinj si dhe të bënte grumbullimin e mjeteve materiale si dhe të angazhohej në aksione të ndryshme që i caktonte organizata. Ishte i rregullt në mbledhjet që organizoheshin në grup.

8. Ejup Kastrati me profesion ishte këpucëtar nga Peja. Po ashtu, po në këtë qytet edhe kishte lindur më 1937. Kishte të mbaruara gjashtë klasë të shkollës fillore. Prej 25 qershorit ndodhej në burgun hetues. Pas bisedimeve që kishte pasur me Ramadan Shalën ishte bindur se Kosova e shqiptarët kishin nevojë për organizimin e një organizate sa më masive ilegale e cila do të angazhohej në luftë për çlirimin dhe bashkimin e trojeve shqiptare me shtetin amë-Shqipërinë. Me rastin e shpërndarjes e ngritjes së flamujve kombëtar në Pejë e rrethinë, ai bashku me Ahmet Zekën ishte angazhua në kontrollimin e rrugëve të Pejës, e mandej i kishte marrë 9 copë flamuj nga Ramadan Shala e këto

në mes të 12 e 13 prillit të vitit 1964, me dy persona të tjerë i kishte ngrit në qytetin e Pejës. Kryente detyrën e përgjegjësit për sigurim në udhëheqësin e grupit lokal.

9. Mehmet Krasniqi me profesion ishte mësues nga Peja. Ishte i lindur më 1937 në Durrës-Shqipëri. Kishte të mbaruar gjashtë klasë të shkollës fillore. Në burgun hetues ndodhej që nga 25 qershori 1964. Ishte bërë anëtar i grupit të Ramadan Shalës diku në fillim të vitit 1964. Kishte lexua dhe e kishte pranua programin e statutin e grupit ilegal si dhe për nevoja të organizatës kishte dhënë 4.000 din. Ndërsa, më 8 prill 1964 në shtëpinë e tij kishte fshehur pakon me flamuj kombëtar të cilat i kishin bërë gati për t'i shpërndarë në qytetin e Pejës më 12 e 13 prill 1964.

10. Vesel Rexhepaj, ishte bujk nga Loxha, komuna e Pejës. I lindur ishte më 1937 në Raushiq. Kishte të mbaruar shkollën fillore. Që nga 10 qershori 1964 ndodhej në burgun hetues. Vesel Rexhepaj ishte bërë anëtar i grupit ilegal menjëherë pas bisedës që kishte pasur me Remzi Balokun e Zeqë Shalën. Ai ishte bërë anëtar i grupit që veprimtarinë e vet e zhvillonte në Loxhë dhe kishte pranua që të angazhohej në zgjerimin e radhëve me anëtarë të rinj, grumbullimin e parave për të sigurua armatimin e nevojshëm dhe në përgatitjen e aksioneve të ndryshme në dëm të shtetit. Me propozimin e Remziut kishte shkua në fshatin Obranhë për të blerë një revolver dhe në një mbledhje të grupit kishte pranua funksionin e përgjegjësit për sigurim.

11. Avdyll Shala, ishte i lindur në fshatin Loxhë më 1933. Merrej me bujqësi. Kishte të mbaruara pesë klasë të shkollës fillore. Në burgun hetues ndodhej që nga 10 qershori 1964. Në vjeshtën e vitit 1963, pas bisedave që kishte pasur me Zeqë Shalën e Rexhep Shalën, në Loxhë kishte pranua që të jetë anëtar i grupit ilegal duke i pranua të gjitha detyrat e obligimet që dilnin nga mbledhjet që i mbanin në grup. Pas takimit që kishte pasur me vëllanë Ramadan Shalën që më herët kishte ikur për Shqipëri, ai me këtë rast i kishte dorëzuar revolen e markës "Parabellum", dhe po këtë revole ia kishte dhënë grupit për nevojat e tij.

Të tëtë anëtarët e grupit si të Pejës, po ashtu edhe të Loxhës: Ahmeti, Nimani, Neziri, Sylja, Mehmeti, Veseli e Avdyli akuzoheshin nga neni 117, alineja 2 të Ligjit Penal të Jugosllavisë. Dhe në bazë të nenit 3, 38 e nenit 117, al.1. e 2 të KP dhe të nenit 88, al. 6 e nenit 90, al. 1. të LPP, Gjyqi i Qarkut në Pejë i dënon:

P. nr. 74/ 64

1. Ramadan Shala, student, (1935), Pejë, neni 117/ 1,2 LP. 21.08.1964. -14 vjet burg
2. Shefqet Deçani, nëpunës, (1935), Pejë, neni 117/1,2 LP. 21.08. 1964.- 9 vjet burg
3. Remzi Baloku, student, (1939), Pejë, neni 117/ 1,2 LP. 21.08. 1964. -10 vjet burg
4. Ahmet Zeka, student, (1939), Pejë, neni 117/1,2 LP. 21.08. 1964. -6 vjet burg
5. Niman Podrimaj,mësues,(1938),Carallukë, neni 117/1,2 LP. 21.08.1964.-7 vjet burg
6. Nezir Gashi, mësues, (1938), Mamuras, neni 117/1,2 LP. 21.08.1964. -5 vjet burg
7. Sylë Shala, punëtor, (1911),Lubeniç, neni 117/1,2 LP. 21.08. 1964. - 8 vjet burg
8. Ejup Kastrati, këpucëtar, (1937), Pejë, neni 117/1,2 LP. 21.08. 1964. -5 vjet burg
9. Mehmet Krasniqi, mësues, Durrës , neni117/1,2 LP. 21. 08. 1964. -5 vjet burg
10. Vesel Rexhepaj, bujk, (1937), Raushiq, neni 117/1,2 LP. 21.08. 1964. -4 vjet burg
11. Avdyl Shala, bujk, (1933), Loxhë, neni 117/ 1,2 LP. 21.08. 1964 - 4 vjet burg

Dhe krejt në fund, duhet shtuar se edhe pse u zbuluan shumë anëtar të organizatave ilegale që vepronin në Kosovë e jashtë saj, megjithatë veprimtaria e ilegales asnjëherë nuk u shua se dashuria ndaj atdheut dhe lirisë ishte më e madhe se torturat dhe më e fuqishme se jeta.

Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA

SUMMARY

**ESTABLISHMENT AND ACTIVITY OF
ILLEGAL ORGANIZATION
“UNIFICATION OF ALBANIAN LANDS” IN 1959**

Documentation available supports the conclusion of four major illegal organizations in Kosova in period 1960- 1965, which could have easily been under one umbrella or that have closely collaborated. Nevertheless, if paid a greater attention with carefully elaboration these four organizations observed significant variations.

In Anamorava operated Metush Krasniqi's organization named "Revolutionary Party for Union of Albanian Ethnic Lands" (1958); in Peja district operated illegal organization of Remzi Baloku named "Organization for Unification of Albanian Lands" (1959); In Prishtina, Mitrovica, Gjilan operated Kadri Halimi organization named "The Committee for unification of Kosova to Albania" (1960), and Adem Demaçi's organization called "Revolutionary Movement for Albanian Unification" (1963). All these four organizations represented a continuation of illegal movements for national liberation from times of the League of Prizren (1878) and hitherto. All organizations established after the WWII in Kosova and other Albanian lands in former Yugoslavia, had their differences and similarities on illegal organizations. Common for all was their goal for liberation off Yugoslav rule, but differed in tone of illegal activities and events organized. They had statutes of political programs, operating anywhere in Kosova and all Albanian territories in the former Yugoslavia. Organizations had broad membership, but often a member of theirs would hold multiple memberships with one or more affiliated organizations. Therefore, when the activity of one of these would reveal by the persecution units, simultaneously illegal activities of other organizations were exposed.

They intensified significantly collaboration through particular intermediaries in the period 1960-1968. Perhaps this caused identification confusion or perplexity between Albanian illegal organizations operating in Kosova.